Kasam ShAQIRVELA

KËNGË TË VONUARA

Biblioteka: M U Z A

autor: Kasam ShAQIRVELA

Redaktimi, korrektimi dhe
lektorimi: Sh.B. “ **V E L A** ”

Librimi: Autori

e-mail: kasamvela@yahoo.com
web faqe: www.kasamshaqirvela.com

© Kasam Shaqirvela.Të gjitha të drejtat të rezervuara vetëm për autorin.

® “Këngë të Vonuara”-Kasam Shaqirvela, i regjistruar si prodhim intelektual.

Kasam ShAQIRVELA

KËNGË TË VONUARA

(p oe z i)

V E L A

Përkushtim

Këtë libër, ua kushtoj të gjithë atyre si: (dëshmorëve, luftëtarëve, të burgosurve politikë, punëtorëve, intelektualëve.....) që, në një formë apo tjetër, e dhanë jetën dhe mundin e vet, me përkushtim, për: lirinë e atdheut, kulturën dhe përparimin e popullit tim !

Autori

DRITA E Y LI I T

Drita e Yllit hapësirën e çanë

Rrugëtimit shqip dhe muret përmbysë

Sojeve përçarëse që ndërtuar i kanë

Errësirën sterrë, mëdyshë ua grisë

ATJE TE DODONA

Zënafillën e kam
I ngjizur nga vetja ime
Rrojtur me zulmë e nam
TEMIRËT e fares sime
Që kur thanë e thona
Atje ku ishte DODONA
Ku qe vendosur Froni
I Atit Perëndi
Të vjetër e të ri
Sot e lashtësi
Nga Zojsi i Joni
Që e lindi Kroni
E mbronte Froni
I bekuar nga i pari
Deri tek shqiptari
Për jetë e mot
Mos t'i ndalet karvani
Sa e ngrohë Ati Diell
Sepse e tij është pjellë.

JAM AI QË ISHA

Unë jam i njëjti!
Po ai që isha
Përkundër kohës
Përplot me tufane
Si atëherë kur kisha-isha?!
Edhe tani kur s'kam-jam?!
Dhe vazhdoj të jem
Ai që sot jam
Për disa melhem
I shpirtit, qetësues.
Sa herë t' më kërkojnë
Më gjejnë dhurues.
Ca tjerëve n'u bëhem
Ferrë në sy
Shqetësues unë jam,
Madje pengesë për zemra
Të zeza sterrë
Dimër e verë,
Përballë rrebesheve
Qëndroj e s'përkulem
Rri këmbën përmbi këmbë,
Unë jam boem dhe poet!
Që hap vet shtegun tim
Dhe shkel rrugës së vet
N'të rëndin rrugëtim?!
Nuk pyes për sfida
E as për ngritje, a
Kukurekje gjelash?
Që koha i tret, e
S'i le për jetë!

MALII PËR ATDhEUN
(M ë r g i m t a r i t)

Sa herë që unë shkoj
Atje, drejt perëndimit
Apo lindjes të udhëtoj
Qoftë të rri atje kohësisht
Ose të shpërngulem për krejt
Si i thuan ndryshe në jetë
Larg e larg të migrojë
Unë s`jam i qetë,
Trupi s'më dhemb
Por i tëri lëngoj
Është vetë trolli
Që mua më polli
Dhe s`më mbështolli
Ndër vete të më mbajë
Nga tjerët mos t`më ndajë
Porse më la të vuaj
Këtu në dhe të huaj
Ah! veç ky truall
Ëndrat mi bën lëmsh
Dhe un' këtu, n`përbuzje

Jam në përçmime

Rri gjithnjë në ankth
Sa s`më plas ky tëmth
Kudo që prek e shkel
Në shpirt jam rebel, e
Zemra fortë më rreh
Për t'imin Atdhe

Dashuri që më deh
Rehati dot nuk gjej
Syri nuk mu mshel
As edhe kur flej
Nga prapa më ndjek
Si hija në shteg
Unin po ma vjel
Ai Malli më djeg
Dhe më përvëlon
Mendjen ma turbullon
Vuajtjet mi shton
E më mban pezull
Në flakë t'ndezur,
Qiri për së gjalli
Ah, i Atdheut malli...!

..... Vullkan Tetova

SI ERDhI ZAMANI

Lumë ne të lumët
Si erdhi zamani[1]
Po të vazhdojë kështu
Do t'na humbë nishani

Shumë kukulla bostani
Shëtiten bulevardit
Qoftë pike e zhegut
Apo erë e marsit

Veshur me xhybe
Lëshuar gjer tek thembra
S'dallohen nga prapa
Janë meshkuj apo femra

Ndërron meselja prore
Kur i shikon nga para
meshkujt mjekrosha n' done
femrat, ''kaçubet '' lara-lara
lidhur me do çallma
për fyti dhe pas qafe
nuk çajnë kokën dollamat
as në pikë vape

sikur bythë majmuni
leshrat për fytyrë
ukubet katundi
po duket n'pasqyrë

[1] koha

u shitë kombësia
nuk vlen më njerëzia
për ca para-dollarë
peshqesh nga Azia
sa një grusht leblebia

Si shumë të përdalë
Dhe ca mysibetë
Pasurinë kombëtare
Na e bënë kurbet !?

..... Uk Sharri

ATY TEK PORTA SKEE

Ti Porta e Madhe, ku hëna fle
N’bedenat e vjetër nën kulm
Porta ime, ti Porta Skee
E moçmja Portë, me nam e zulm‘
Aty, t’parët e mi, më patën le
Me fat tragjik e fund të pafundtë

Shigjeta t'Akili edhe t'Odiseut
Prite n’ballin tënd të përflakur
T'gjakosën sikur thumbat Prometheun
Tuajt ta përmbysën t’votrës pragun
Të tjerët, në fyt, ta vunë lakun

Dielli këtu lind edhe më i zjarrtë
Qielli me detin puthen hiç pa nda
Dashuri hyjnore e njelmët si kripa e re
Çfarë fate njerëzish ndanë molla e artë?
Kundërmon histori kjo tokë e lashtë
Shpata e Damokleut më dysh për ta pre.

Këtu dhe zoti të shikon ndryshe
Dridhet dhe foshnja që akoma s'ka le
Përveç se lejlegë s'ka më dallëndyshe
T’i këndojnë këngët e moçme
Aty tek Portat Skee
Fusha përpara, e mbushur përplotë
N'damarë të grisur, fytyra n’lemëri
Si det i mbuluar nga të derdhur lotë
Mungon veç zemra, kohën e mbajmë në gji.

Dhe, vetë unë, me sytë e mi i pashë
Tek ngjitesha bedenit të Portës Skee
Aty pranë, shkëlqimit të trimave,
Iu përkula në shpirt, në gjunj u rrashë
Akil, Hektor, të tjerë...dhe Odhise,
Bisedonin me një gjuhë bukur të trashë
Thonin vetë me vete, ç'është kjo marëzi ?
Vallë, ç'po i bëka vëllau vëllasë?!

Vetë unë, me dorë i preka,
Imazhin syve ua dhashë
Heshta të thyera, mburoja të çara
Parzmore të shqyera si barqe luajsh[2]
Shtrirë ndër muret e kalasë
Si t'ishin kurban a flijim buajsh.

Mendjes mi rrinin rroje përpara
Trupa luftëtarësh dhe kuajsh të rryer
Mbushur bregore e lugje ndër ara
Nga gjak i ngjizur me lotë përzier
Mbetur syhapur me dritë të fikur
Etja për lavdi, vepër e pakryer
Veç një çast i smirës prore
La një vragë që as koha se fshinë
Një fund tragjik i një kulture njerëzore
Ndodhi e mbarsur për njerëzinë.

Tek Porta Skee kur binte mbrëmja
Aty përpara saj luhej drama
Edhe kur mëngjesi i bardhë gdhinë

[2] luanësh

Mbaronte një akt i zi me tragjedinë

Sërish pritje në ankth e drojë
Nga dhuratat si Kali me rrota
Klitha njerëzish në plojë
Aty hapej, aty mbyllej bota

E shtruar dhe pyetja si trilogji
Cila qe e para?- as vetë s'e di!
-Bukuria femërore për dashurinë?
-Lavdia e verbuar për pasuri?-apo
-Krenaria e lidhur për trimërinë?
Të gjitha këto e bënë historinë
Që atëbotë dhe sot një mister,
Mbeti kjo enigmë që kërkon liri
Zbërthimi i saj t'mos mbetet n'terr.

shkruar te pragu i rënur i Portës Skee
Trojë, 17- prill-2004, Ora 18:45

NËN DEGËT E LISIT PLAK

Gjarpinjtë strofullën e kanë nën gur?!
Ti njeri i mirë, mos gabo ta përmbysësh
gurin e shtëpisë
Se, për mirëseardhje do ta keshë helmin
e gjarprit të fjetur galabuc në mur?!

Por ama i përgatitur duhet të jeshë!
Aty nën detgët e Lisit kur të fleshë?
Njërin sy lart në qiell ta mbashë n'kaltërim!
Me tjetrin horizontin ta kapësh n'agim !

Milingonat do të vijnë në stres
Qyqet çerdhe nuk ndërtojnë?!
Hienat sojin e vet e hanë,
Kur preja u mungon përreth!

Mos ia vë veshin askujt !
Shpatën e ke varur në Lis
Koha ta miklon mjekrën e bardhë
Më të bardhë se yt plis në fis

Fjalën e ke rrufe, ndëshkuese gjarpinjsh
Shpata dytehëshe, pret dhe vetëm pret
Mendjen e ke top që fortë godet
Milingonat le të bëjnë punën e vet

Sehirxhinj, përbuzës dhe matrapazë
Le të gostiten me vuajtjet e tua?!
Bateritë që harxhohen nuk mbushen dot!
Flaken në kosh-plerhrash për jetë e mot!

Lis-Plaku yt krahëhapur ty të pret
Me afsh lirie n’përqafim të thërret
Mpriph shpatën për beteja tjera! Thot,
Korr dhe vetëm korr suksese t’reja !

Nën degët e Lisit Plak ti qëndro e mos tret!
Sepse, aty s’të lag as shiu i rrebeshtë
E nuk të godet as e ashpra rrufeja!
Vetëm ashtu, mbaje mend mirë, biro!
Ty, të rritet e lavdishme epopeja!

Lis-Plaku yt, degëhapur, kohën e vret
Kapërcejtë e shekujve n’përqafim i thërret
Porosi e amanete t’i bëjnë realitet
Ti, mprih shpatën për beteja të reja!
Nën degë të Lisit qëndro e mos tret!
Aty asnjëherë s’do të kapë rrufeja.

PRITJE ShEKULIORE

Sot edhe dita agoi ndryshe
edhe dielli buzqeshi prore
do përmbushet amaneti i t'parëve
për këtë pritje shekullore

Bota demokratike vlon si zgjua
n'përpjekjet për stabilitet,
Ballkani-fuçi baruti, u pajtua,
nesër Kosova po shpallet shtet

Edhe bastardët tashmë janë gjunjëzua'
pas shum' shantazheve, absurditet ?
turpërisht e me pezëm u kuptua
i pashmangshëm është ky realitet !

Çdo shqiptari, zemra fort i rrah
në këtʼ çast të madh e historik
demokracia perëndimore i rri përkrah
padrejtësia ngadalë po ik

Për ju martirë, për ju dëshmorë
gjatë shekujve ndër gjenerata
Diademë xhevahirësh në kurorë,
historia shkruan me shkronja t'arta

Ëndrra e juaj, e bardha sot
nis e po zhgjëndërrohet,
nesër mbase për jetë e mot
plaga jonë e përgjakur,

përfundimisht do të shërohet

Feston Dardania prekshëm sot
Përshëndetje vinë nga bota mbarë
uron Ilirida, uron Çamëria pa lot
e nesërmja, bujshëm na thërret,
t'bashkuar qofshi shqiptarë !

Tetovë, 16.02.2008

YJE TË NDEZUR FLAKË

Zgjuar ndër shekuj gjithmonë i prita
N’shqetësime shpirti si dita rrojta
Gjeneratat ndershëm vetë i rrita
Rrudhje tokash, n’vrojtime u drojta
Eca në tatëpjeta dhe përpjeta ngjita
Kurrë me ty unë nuk u ngijta
Etja s’shuhet me pika pika
Ti mu bëre qerpik ndër vetull
Varun n’qiellin përplot me Yje
Nderin tënd ta mbajnë nën sjetull
Yje të ndezur në flakë Lirie
Që stolisin qiellin bukur n’amshim
Si t’mëdhenj e t’vegjël në shkëlqim
Si afër a largë, njësoj ndër dije
Të gjithë shndrijnë dritë Lirie
Ndërpemi vuajtjet në gjakim !
Kallma zemrën n’qirinj ndezur !
Hiqma njëherësh flakë e tym !
Përreth qafe litarë përdredhur ?!
Kthema dritën ndër sy t’vrarë !
Edhe ti Bir i Arbrit t’bardhë
Tani mos flej të rëndin gjumë !
I Fisit tënd është ky Milenium !
Djersa, lot-gjaku, t’rrodhën lumë
Sot o kurrë koha ka ardhë
Ta kthesh atë në ar të bardhë !
Se mbërrijti i madhi tashmë n’kulm
Jakë or jakë n’Kalë të Bardhë !
Si Prijatar i moçëm me nam e zulmë.

Prizren, 22-shkurt-2008

RAPSODI KËNDOI EPOPENË

Një tingull i fortë po afrohet zhurmshëm
Ushtima veshët po i shurdhon
Kambana e Lirisë tundet furishëm !
Thuan trishtueshëm ajo tingëllon ?!
Për at' që shkel Dheun e huaj pranishëm
Ngulfatje shpirti, atij i shkakton ?!

Zëra të këqinj seç po marrin dhenë
Nga shtypës barbarë me shokë përrreth
Që kur rapsodi këndoi epopenë
Kërcënime shterpë dolën në shesh
Dhuna me dhunë thuan ndalohet ?!
I ftohti, veç me të ftohtë dëbohet !

Borisë bjeri fort, mos u ndal në histori !
Nga Kepi i Shpresës Mirë mesazhe dërgo !
Oqeanit, trazoja valët deri në thellësi
Dhe peshku i shurdhër le t'i ndijë këto
Sa gjatë po të shtrihen ca vello padrejtësi
Fitimtarë dole sot, tjerët të shpallën hero!

Paqen përhap! -le ta përqafojë dhenë !
Pëllumbat e Bardhë lëshoi lart në qiell !
Historia i gjykon ata që gënjejnë
E vërteta del në shesh n'kohë me diell ?!
Herët a vonë pamëshirshëm të godet
Një Bumerang të fortë peshqesh ta qet

Të pushtuan, të copëtuan, të aneksuan
Su ngopën ujqit gjak duke pirë

Këngë të vonuara

Dorëzim e nënshtrim s'njohu raca jote
Mbete ai që ishe dikur e sot, Dardan-Ilir

Durimi yt promethian, arriti deri në qiell
Amaneti të gjëllin, shpresa kurrë s'tu nda
Ty të shpërbleu paqëtor, i Madhi Diell !
Le të kuisin lukuni armiqsh, pa çka ?!

Ti, Ati im, ti Atë i vjetër !
Mbret mbi mbretër e At' mbi Etër
Ma thoje dikur me gojë e letër,
E vërteta vonon por nuk harohet !
Ata që s'patën as shpirt, as zemër
Plisin e bardhë, ta ndërruan me tjetër
Ta përmbysën pragun e Shtëpisë Vjetër

Ëndrra e rendë mal, më shqetësoi !
Por, mesazhi i shpersës më vinte pa da
E sot Dita e Arbrit e mbarë më agoi
E vërteta e ime, plumb në zemër u ra?!
Rëndë shpirtzinjët tashmë i qëlloi
Mbase nuk do ta provojnë kurrë më !
As do t'iu bie ndër mend lukuni me bë.

Prishtinë, 23-02-2008

VETËMOHUESI
(maratonistit tetovar-Ademit)

Kafenë e zezë të mëngjesit si rëndom
e pi në zyrën e punës, n'meditim
dhe ndoshta si njëfarë paradisponimi
për punë të rëndomta ditore, po thom
apo nganjëherë edhe për ca inspirim
për ndonjë poezi a të shkencës shkrim.
E sot: 28-shkurti-2008, pak sa dalloi,
dita e ejte me diell dimëror agoi, e
më gjeti në restorantin "ARBI", n'kërkim
të mikut a shokut për një bashkëbisedim.
Hyra aty, ku njerzit i harojnë hallet
vetëm për pak
takova dy shokë; njëri mori kafe të zezë
per të vetin merak
ndërsa tjetri pak sa tejkanoz, me akull porositi
wiski-konjak
ndërkaq, i treti i panjohur për mua, aspak !
para vetes, gjysmë gote lëng portokalli, i qetë,
fare çunak
nuk ma mori mendja se, çka i fshihet pas atij trupit
të njomë e ftillak?
i vendosur dhe vetëmohues,
djaloshi marathonomak.

Ai, për nder të pavarësisë së Kosovës,
dje, vetmas fillkat, si ati
kishte vrapuar marrshutën prej
107 kilometrash, gjatësi kjo,
e kaluar në vrap, malores e rrafshinës

i nisur n’mëngjes nga Universiteti i Tetovës,
e takuar me shokë në Sheshin e Pavarësisë,
aty në qendër të Prishtinës.

Maratonisti i zellshëm, ky djalosh i ri
gjatë vrapimit heroiko-stoik për tek Mëvetësia
kishte hëngër dëshirën e flaktë!-për vete Tagji,
madje, pa ndaluar tek ndonjë burim freskimi.
Ah, Liria !
etjen ia kishte shuar djersa e kripur e ballit të tij
nga etja që kishte, bërtiti me sa kishte fuqi
Le të rrojë Pavarësia!

28, shkurt, 2008
Restorant ARBI, Tetovë

LIQENI i STRUGËS

Sot e dielë ditë pushimi
Tek po rri aty ke Drini
Po e sodis Liqenin e Strugës
Që m'i pret e ngjet mendimet e mia

Valët e ujit në liqen
Bisedojnë njëra me tjetrën
Shoqja shoqes seç i rrëfen
Një këngë liqençe me refren

Këngë e vjetër sa vetë vendi
Në gjuhë të vjetër sa vetë populli
Këndon liqeni ditë për ditë
E kupton vetëmse ai
që është nga perënditë

E dielë , 26-maj-2002 Strugë

DETI NË TETOR

Deti po fle i qetë, po fle
Nuk ka turistë ngazëllues që ta trazojnë
Ka ikur vapa bashkë me verën
Plazhin Ilirija n'Durrës, era e përkëdhel
Tani lahen vetëm mjellmet në te, që
Horizontit të kuqërremtë fluturojnë !

Durrës, 20 - tetor – 2003

DIALOG NDJENjASh E ËNDRrASh

Në natën e qetë, e pyes un', Muzën vetë !
Përse vallë, më fton në kuvendime ?
I them asaj prerë, t'më lëne të qetë !
Se, mi ka do halle kjo jeta ime !
Shpejt, ma kthen Muza pa hidhërime ,e
M'thot: zbrit nga Pegasi ti, më parë !
Të t'i them vet' unë, dy fjalë
Nuk të grishi unë për dëfrimet
Por, zemra yte më puth me mallë
E pastaj, ndjeshëm m'i jep sublimet !
Po të them, jepi udhë ti dorës sate!- me
Penën e Artë le t'i qëndisë rrëfimet

Mbrëmë vonë, natës me hënë
Seç bredha malit dhe lumit pranë
Aty pashë hënën tek lahej
N'ujë të burimit, si po shpërlahej
Iu afrova unë ngadalë
Seç mi kapi veshi do fjalë
Për një çast dhe u harova
N'shijim të t`mirës si u lëshova
Nga Bukuria e pashoqe u rrobërova
N'livadhin e kadifenjtë, unë pushova,
Një tufë lulesh të bukura i përqafova
Mes tyre, gjatë, unë qëndrova
Aroma e tyre këndshëm më dehu
Trupin dhe shpirtin mua ma prehu
Inspirimi papritmas ati ia behu
Muzën dhe Zanën sërish u takova
Në gjumë të thellë unë rrashë

Këngë të vonuara

Shum' ëndrra të bukura aty pashë
Anembanë historiesë s'ime i rrashë
N'prozë e n'poezi gjërat ia thash
I këndova, madje edhe i vajtova
Brez pas brezit ua përcolla
N'shpirt e n'zemër ua mbolla
Dëshirën për dije ua dhash

Mbrëmë, në natën e bukur, thënë,
Edhe pse ishte e errët, pa hënë
Sikurse e bukura nuse,- shtatzanë
Përsëri m'kaloi Zanë-Muza pranë
Ajo m'përshëndeti e ma dha përqafimin
Edhe unë e perkëdhela, s'e lash pa e puthur,
Vetëm ndjeshëm dhe ashtu lehtë
Ajo, si peshqesh ma dha inspirimin
Ndrërkaq, Pegasit të shaluar si për ditë dasme
I përshpëriti diçka të rendësishme n'vesh ?!
Mbase ia këndoi këngën e spasme t'Balës
pastaj, ia përkëdheli jelet Kalit Bardhë,
I ra vitheve paksa rëmbyeshëm
Se ç'mori përpjetën Gjoku, rrufeshëm !
Më tha, mbahu ! -or thinjosh plak!
Për jelebardhë kapju Pegasit
Bashkë me nusen në duvak
Ti për Muzën mos ki merak
Se, atë, e takon shumë lehtë
Po qe se s'pari, i përgatitur je vetë
E pastaj dijen, ndër libra ta keshë nxënë
Dhe varg të pakëputur ngjarjesh të kesh' vënë
Tamam, sikur brumi që pret për tu gatuar
Nga një mjeshtër kuzhine, me dije e përvojë

Pritëm, se vij aty vetë, hiç pa u hetuar
Unë, me kënaqësi, do ta jap inspirimin
Që ti pastaj, me Penën e Artë,
Bukur ta qëndisësh shkrimin.

SYTË E TU TË BUKUR
(vajzës Iliridase)

Sytë e tu të bukur, si shkëndijat ndezur
Rrezatojnë shikim aq depërtues n'behar
E stolis fëtyrën tënde kjo bukuri e rallë
E sikur t'mos ishe ti kjo që je vallë
Ata, do të shndritnin si dy Yje bashkë
N'hënë të plotë, qiellin që puthin me ashk

Ngjyrat e detit në to janë shkrirë
Bashkë me t'qiellit puthen n'harmoni
Dashuria jote është dashuri e dlirë
Ëndrra e mëndafshtë të përkund në gji

Po e pyet poeti realitetin tash
Pse zgjohet Afërdita n'Pranverë ?
A thua vallë mosha mos ka vakur
A Muza e grish dhe i bën nder?
Dhe Thinjosh t'i hypë Kalit me Flatra
Zemrën poetit për t'ia përflakur
Akoma ka, them, do t'them dhe thash
Për miqësi s'ka zemër të plakur …!!!
As që ka pasur dikur, e as që ka dhe tash!
Eh! -sa do të kisha pasur dëshirë
Të isha unë, pikërisht unë ai
Që me afsh do ta shuante zjarrin
E atij shpirti të kallur n'dashuri

Thuan që, bukuria fizike forcohet atëherë,
Kur e ushqen fisnikria e shpirtit të afshët
Në djepin e përshëndetjeve të mia, ngrohtë

Le të përkunden ëndrrat e tua të mëndafshta
Deri n’zhgjëndërrim vet, të ëmbel e t’fortë

Oeneum, 14-^{tin}, e marsit, ...
….Shekullin e kaluar

LOKEJONA

Lokejona duardhëna
kurrë s’të merr a veç të jep
zemërmira shpirtgjera
ta nis famën qysh në djep

Lokemira, fatmjera
jetënxira në ditë t'vështira
shpirtdëlira,fytyrëqeshura
e jetës ballëngjeshura.

Për acar, me yll në ballë
në pranverë, shend e verë.
lidhur ballin me shami
pret e përcjell tri pale krushqi.

Lokejona, Nënëmadhja
fatbardha
shpresëdhënësja
e jetës dijenxënësja.

O e jona gjyshorja,
përrallorja…!
nina nana, për nipa
e mbesa, ninullanja.

Lokemira flokëthinjura
fatdhënësja, dashamirësja
djeppërkundësja
Lis-lëkundësja
zjarrruajtësja

Votërpruajtësja.

Në zjarrishtë të moçme
plot e përplot me prush
i ruan kujtimet e veta
zjarrin ç'e përpush.

Atë zjarr zemre dhe të gjakut
brez pas brezi të kësajë toke
se len të fiket atë zjar të vjetër
Kjo Nëna e Madhe, kjo Nëna Loke.

Ditiramb porsi shkëmb
ndër rrebeshe me buzëqeshje
rrit luanë zemërgjerë
si viganë
si për komb dhe për vat(ër t)anë.

Nënëlokja, Lokejona,
ne shumë i gzona[3]
Nënës Loke, simbol epoke
të kësaj Toke.

[3] i gëzohemi

KUR I FLET ShPIRTI POETIT

Koha gërryen dhe nuk pyet më
As uthulla s'pyet për qyp të vet
Kron-o-si i gëlltit pamëshirshëm?!
Qofshin ata dhe fëmijët e vet
Koha, favoret e veta ofron
Dikush rend i pari t'i merr
A dikush lindet dhe kameleon?!

***

Shqipja, kjo gjuhë perëndie!
Gjininë asnjënse të vetën e ka
Ata që i takojnë kësaj gjinie
N'udhëkrryq jete ndodhen papra
Nuk treten dhe as tjetërsohen
Asketë lindin, asketë vdesin
Karakteri i tyre nuk njeh stina
Të njëjtë, fillim-mbarim mbesin!

***

Unë jam i njëjti u tha poeti
Kur e pyetën ujemxhinjtë
Po ai që isha, jam për veti
Përkundër kohës
Përplot me tufane
Si atëherë kur kisha
Edhe tash kur s'kam
Dhe vazhdoj të jem
Po ai që sot jam.

***

Për disa jam melhem
I shpirtit, qetësues
Sa here të më kërkojnë

Këngë të vonuara

Më gjejnë dhurues
Ca tjerëve, n'u bëhem
Ferrë në sy
E kanë nga vetja
Që s'janë me ty
Shqetësues un' jam,
Madje dhe pengesë
Për zemrat gogël
Që mbetet e vogël
Dhe e zezë sterrë
Dimër e verë.
Përballë rrebesheve
Qëndron e s'përkulet
As nuk pendohet
Dhe as nuk gërbulet
Pra, tekat dhe huqet frenim duan
Shpirti i poetit për fjalë t'bukur vuan
Nëse e do puna dhe jeta flijohet
Pas shtatë kodrave e mira kërkohet
Zotnia, këmbën përmbi këmbë qëndron
Dhe natyrshëm e kap të vetin fron!

***

Edhe pse tani u ka ikur koha
T'bukurave, sendeve me vlera
Dhe as që pret të vijë një kohë tjetër
Shtigjet e mbyllura përplot me ferra
I hap vet si asket i vjetër
Ai ësht' boem, e i tillë do mbes!
Rrugëtimit të tij heshtas shkel
Por qëndrueshëm dhe pa siklet
Orteku i madh nuk e vë në stres
As derën atij nuk ia mshel.

***

Poet është ai që bën stilin e vet
Dhe shpirti i tij gjithnjë flet
Nga Kënga e tij edhe lulja çel
Vajin n'këngë vetë e shndërron
Vargu i tij shtërzim nuk duron!
Mbarsje ndjenjash nga tjerët s'pret
Por veç nga një vashë puthjet i merr
I thuan Muzë, ëmbël t'këndell
Ajo përqafon vetëmse poet
Gjakun ua ndez aty në dell
Edhe Pegasin ua shalonë vet'
Shpirtin ua prek, ua puth me ashk
Pastaj vullkani, vetë shpërthen jashtë.

***

Atij s'i duron truri shpërjarje!
S'i pranon as helmim shpirti!
Sepse nuk i shkon për shtati flirti
Shum' e brengosin fyerje e sharje
Nuk pyet ai për sfida shterpe
As për kukuritje gjelash n'portret
As për klithmat memece, që
Koha n'vazhdim lehtë i tret!

A N K I M I

Sot, nuk mjafton veç me u ankue
pa çka se jemi n’të drejtë ne
aq shpejt koha asht tuj shkue
asnji e vërtetë si ve fre

Sytë hapun për veten tonë
domosdo duhet ne me i pas
kshtu na do dhe perendia
kshtu dhe hasmin kem me plas

Edhe **Shoa** në lashtësi
që kish në vete niqind sy
sa herë që gjysa,mbylltas i pushonte
gjysa tjetër vigjilent vështronte

Edhe tani n’milenium të ri
lugetët u ringjallen përsëri
pra, në vështrim synin ta mbajmë hapun
thikat pas shpine n’kohë për me i kapun

T’mos ia lëmë askujt,të paktën vetë ne
ashtu lehtë me na ba t’veten pre

Tani o kurrë, asht koha dhe momenti
për me e nxjerrun ne veten n’pah
pastaj nga dashamirët tonë t’kërkojmë
të renditen bashkë me ne përkrah

A s’po e shifni ju tani?!
Para syve çka po na ndodh

Këngë të vonuara

Politika i ka varun veshët
Para hunde gjithçka i ngjeshet

N’Veri po luhet loja bizare
Aty, mu në tokën tonë kahmot
Në pikë dreke, pa turp fare
Sukur kjo tokë t’ket tjetër zot
Akoma plagt e vjetra nuk janë mshelë
Prapë do të reja na i kan çelë

Por, as dhe Jugu nuk mbetet mbrapa
me hapa t’matun punojn pasosun
me na e kafshu trupin edhe nji herë
u turën hienat n’Luan t’plagosun

A VONOHET PRANVERA

Vallë, a thua që po vonohet pranvera ?
A thua diellit rrugën ia kanë zënë ?!
Apo dimri është i egër, e po e zgjat stinën
Hënën, si nusja në pajë, zymtas e kan' lënë

Loket kërusur përkundin djepat e Lisit
Dhe lotët gatuajnë ninulla ashtine
Legjendat që thërrasin për brezat e fisit
E kanë gati kurorën me gjethe dafine

Vashat e vashëruara ylber kapërcyer
Po ia krehin jelat gjokut të lidhur
Gërsheta-zënur që miklojnë gjunjt'
Përtypin e kapërdinë të vërtetën e hidhur
Pyesin e po pyeten. Përse vallë tani
gardhit të ashkët po i lëkunden hunjt'?

Një thirrje që ndez zemrën e stërmolisur
Ecën nga larg e, thellë, thellë gjëmon
Shpresë e shterur shtigjeve, sërish gjallëron
Varur si vathë n'vesh, zëshëm kumbon

Përse prisni? Shalone pra Atin Gjok!
Nxirrne jashtë, le ta shkelë lëndinën !
Le të përmbushet amaneti i Babës-Lok
Si i Kostandinit me Dorontinën

Dhe i thoni ju, madje, hiç pa prituar
Edhe pranverës, asaj t'bukure stinë
Ne jemi këtu e s'kemi t'haruar
Edhe kur natyra e vonon blerimin
Gjoku jonë lirshëm, vrapon n'lëndinë.

Preshevë, 19 / qershor /2005

DhJETË MINUTA NË VIGjILJE TË VITIT TË RI

Vitet vijnë e shkojnë pa u hetuar. Si gjithnji[4]
por euforikisht të festuar. Sa çudi!
Koka është shtatzënë dhe më rëndon mbi supe,
më rëndë se pesha e viteve të mia.

Shumë çështje të pazgjidhura, shumë kriza globale,
si dhe shumë probleme individuale
më kujtohen në këtë natë më universale
dhe më festive, e cila nuk dallon:
as racë as ngjyrë, as religjion as moshë, apo
dykëmbësorë i rëndomtë qoftë, a kampion?!

I vetmuar, në tavolinën për katër persona,
po darkoj me hijen time; bisedoj pa zë!
vera e kuqe më bën shoqëri, për kënaqësi
të momentit dhe dëshirës për shumëçka që
nuk realizohet sonte, megjithatë shpresohet
pafundësisht dhe marrëzisht dëshirohet.

Sonte realiteti duket lakuriq, ngase kështu
ka lindur nga nëna e vet; Zonja Jeta
që ndokujt i hec për toke, e ndokujt
i jep, madje edhe i hap fleta[5].

Disave, në jetë u shkruhet me laps, bile
që e fshinë shumë lehtë edhe më e keqja gomë
ndërsa disave u gërvishtet me gozhdë, në dhimbje,
në vrazhdësi, që se shlyen asnjë bombë.

---

[4] gjithnjë
[5] flatra

Këngë të vonuara

Të gjithë urojnë diçka duke cakruar. Thuan:
“Gëzuar, shëndet, suksese, për jetë të gjatë…..!
Akëcili sipas asaj që më parë e ka konceptuar
Gjithkush sipas fatit të vet, që “i lumi” ia ka shkruar

Sado që dikush të mundohet, fatit të vet t’i ikë
kot e ka lum miku, këtu muhabetit i vëhet pikë.

Vitet sikurse vijnë, ashtu edhe shkojnë
si Unë, si Ti, gotën e cakruam për ato që
dëshiruam.

Mirpo, mos haro i nderuar festues n’gazmend, se
jelekun tjetërkush ta pret dhe ta qep?!
të vin mirë a s’të vin mirë ty, apo të jep siklet
kush nuk po të pyet për atë dert.

Ti personalisht, vetë, merr dhe jep
kuptohet n’ballafaqim dhe n’balancim
sipas mundësive që jeta vet t’i lejon
madje hiç pa na pyetur, as mua as ty
o mik i dashur, a i dua unë apo ti s’i don?!

I L I R I D A

Ilirida trime sot këndoj për ty
Emër i moçëm i vendit tim
Nder e lavdi, ecin bashkë n'histori

Ilirida jonë, nusja pa kunorë
E bekura ti toka Arbnore
Dasmorët i ke të gjithë dëshmorë

Iliridë ti toka e kuqe !
E jona je, të kemi lulkuqe?!
Sa shum' vjet më rri nuse ?

Nuse e bukur n'kalë të bardhë
Vallë, pse s'del dhëndrri me t'marrë?
Për me t'fut n'Shtëpinë e Madhe

Ilirida e dashur, ti nëna ime
Un' jam ai ashti i stërvujtun, i yt
Mbushun me kujtime e hidhërime

Nga bishat më t'egra të kohës, që
Nisun nga mot e deri më sot
Sërish n'përtypje u mbetem në fyt?!

Aty, te pragu i kasolles s'ime të vjetër,
në pritë, vra e pre për liri. Iliridë për ty!
Për Flamurin Kuq e Zi, zbritë e ngjitë?!

Iliridë bukuroshe e fjetur! Ti toka Hyjnore!
Edhe sot më mbetesh prore

Këngë të vonuara

Brez pas brezi e jona, Arbërore !!!

Ti je tokë e pasur në çdo anë
Me pyje dushku edhe ahu
N'qiellin tënd shqipes i hapet krahu

Kullotat i ke me burime shumë
Natyra jote parajsë e vërtetë
Kujtimet e mia më rrjedhin lumë

Vetëm në ty i qetë më fle shpirti, e
Zemra më rritet mal nga gëzimi,
Ah!-po më duket se troket bashkimi?

Sharri Plak,Ty, po t'rri kunorë !
Seç të buzëqesh prej mija vjet
Thot!- nuk vin nusja pa dasmorë?!

Është i mërzitur, verë e dimën pi duhan
Veshun me tyrq të bardhë si dëborë
E mban ngjeshun martinën me jatagan

Syri i tij, shikimin s'ta ndanë dot, as
Nuk ta duron lotin varun për qepallë
Gëzohju pranverës Iliridë, sot e mot!

Yllin e Fisit mbaje nalt në ballë
Le të bëjë dritë prej thellësisë
Kështu i mbyllet goja historisë!

Ç'pret më? Hidhe vallen e lirisë!
Sikurse nusja në oborin e vet

Këngë të vonuara

Sot o kurrë ndërgjegjja të thërret

Bashkë me motrat e tua të reja
Ti, mos lejo të t'prekë rrufeja!
S'të thehet Uni që tre mij' vjet

Nji, Kallnuer, moti 1992
Pellag, ILIRIDË

SI TA VRAS MËRZINË

Mbrëmë dëgjova lajme jo të mira
Dita e nesërme mu gdhi disi e zymtë
Mendova me vete si ta vras mërzinë?
Kush më vie në ndihmë, rakia apo bira

Aty pranë zyrës sime
Një restorant sapo hapej
Si lulja kur petalet nga dielli i çel'
Thash vetë me vete, mbarova un' i shkreti
Rakia e rushit para syve po më del

Vajta e u ula pranë një trëndafili
                    të posaçelur
Porosita raki dhe mezenë, terjaqi !
Se si u deha për pak çaste,
As un' vetë nuk e di !
Ishte aroma e trëndafilit të kuq ?
Apo ajo e rrushit, ah, e bardha raki?

Por seç mu bënë lëmsh
Mendimet pështjellur
Ma trazuan shpirtin, e
më futën në mërzi
kështu si gjithëherë
ndodh për çudi
sa herë të ulen bashkë
trëndafili me raki….

kërkova ndihmë, shëtitur
ndër kujtime të brishta,

për njerëz, ndër kohë
të ndryshme, të trishta
por, papritur mu shfaq
ajo skena e vyeshme
Diogjeni, me fener në dorë
po kërkonte njeri ?!

Qesha vetë me vete
Porsi i çmendur
Me kujtesën time
pak të rënduar
po ç'të duhet Diogjeni
tani të të kujtohet
apo ndonjë filozof të përmendet
shiko edhe ti sikur shumë të tjerë
se jeta e ëmbël nëpër terr po bëhet
lëri ti meselet e diturisë, sepse
bashkë me të karakterit,
tashmë i takojnë historiesë.
Prapë seç mu shtua mërzia e shkretë
se vetëm rakia më bën medet
ua kam lakminë zagarëve langonj
sepse, s'jam i aftë si ta të vrapoj
nuk e di se si e heqin mërzinë
më lehtë se ta rrotulloj tepsinë
ah, seç e kanë hak zagrinë !
Sërish Diogjeni
po ma turbullon ujin,
sërish mendimet
shtegtojnë më herët,
sot kush s'po pyet
për t'vetin apo t'huajin,

është moda, kush sa po i ndërron
qerret, sa vila i ka dhe tek i ka
sa ’’mall ’’ po shet e sa rini po vret
sot e gjithë ditën, deshëm a s’deshëm
ky është realiteti i jonë, herët a vonë
që deri në palcë e zhveshëm,
si shumë sëmundje të rënda,
ndër ta edhe e përçudta sida,
na rrinë varur n’qafë kumbonë[6].

[6] Këmborë

EMISARËT GRI
(fytyrat e hirta)

Emisarët gri po defilojnë
Qytetit dhe fshatit qarkullojnë
Ditë për ditë po na shtohen
Si gjarpinj po shumohen
Tufa-tufa po na bredhin
Farën e të keqes mbjellin,
Ca me shkollë e ca pa shkollë
Gjithë një qime, mjekër hollë
Inxhinierë a profesorë
Disa juristë e ca doktorë
Na përhapin një farë të re
N'është parim apo fe
Kush e di se ku ka le
Këtu tek ne po përhapet
Ashtu haptas po përkrahet
Edhe turpi me bukë hahet
Pa çka se jemi edhe të vjetër
E kemi tonën krejtësisht tjetër
Tani kthehemi e përbuzim
E lavdërojmë Sulltan Topuzin
E përmendim ditë e natë
Rrofshin e qofshin për ne paratë
Për to digjemi si dru i thatë
Veç t'i fitojmë na interesonë
Se për çështje s'na bëhet vonë
Emisarët po qarkullojnë
Shoqi shoqin ta takojnë
Rrjetin e vet ta zgjerojnë
Që biznisi bukur tu rritet

Këngë të vonuara

Edhe paga mos tu ndërpritet
Vaj medet për këta të mjerë
Që e kanë shpirtin sterrë
Dhe ndërgjrgjen e rënduar
Punë të këqia duke punuar
Ditë e natë po mundohen
Sa ma shumë të pasurohen
S`pyesin për çështje apo gjini
Duken njësoj në fytyrë,të gjithë gri
S'duan të dinë për komb
As nuk e dinë ç'është kauzë
S'janë as për shkop
Dhe as për tërkuzë
Vishen e mbështjellen
Si kukulla bostani
Lum për ato që mi ka jarani
Djersën e trupit ua fshinë jorgani
Mbahen e hiqen se janë të pastër
Tamam si halja që rri në ngastër
Në mos paçë punë thuaje të vërtetën
 Në veshë të shurdhët ajo zatetën
Shoqëria jonë matën me kutë
Atje ku s'është fortë,e gjenë butë
Presim e mbesim edhe ne me shpresë
E dimë që i përmjerri s'lahet me vesë
Tradhëtitë e tyre s'i lanë as lumi
Gajret bre burra se na mbyti llumi
Po qe se neve nuk na del gjumi
Të këndellemi një herë e përgjithmonë
E ta flakim përtej qenies sonë
Këtë vello gri edhe me lara
Kurrë më tek ne, mos i mbiftë fara

S'ka se ç'na duhet ky lloj marifeti
Që e sjellin marifetçinjë nga “kurbeti”
Ngjizur me drizë nga farë laneti
Sikur dhe na qoftë parim apo fe
Lulzoftë e qoftë atje ku ka le
Ne e kemi tonën një komb dhe një fe
Të gjithë sa jemi një nënë na ka le
Me gjuhë të shqipes n'djep na ka përkundur
Kurrë për jetë t'jetëve mos me u lëkundur
Të mbesim ata që jemi e ishim ngaherë
U bëmë mysliman se ishim të krishterë
Të rritur me dhallë a me t'kuqen venë
Të lindur në dimër a në stinën verë
Mos ta lejojmë që t’na përçajë feja
E jona është, si e vjetra dhe e reja
Të gjithë për një, një për të gjithë
Sikurse degët në të moçmin Lis
Vetëm ashtu kombi do t'na ruhet
Kështu Shqiptaria kurrë s'do të shuhet.

… Uk Sharri

E … PO PYES….?
(a ka kush të më përgjigjet ?)

Pse u përpoq sot e mot
shqiptari, përse ?
Pse derdhi djersë e lot
punëtori, përse ?
Pse e la gjakun maleve
luftëtari, përse ?
Pse e flijoi jetën e vet
dëshmori, përse ?
Pse reagoi me penë
shkrimtari, përse ?
Pse kundërshoi haptas
intelektuali, përse ?
Pse bëlbëzoi fshetas
pseudo-intelektuali, përse ?
Pse s'debatoi çiltër
politikani, përse ?
Pse s'ngrihet i vogli
e ta shtrijë viganin, përse ?
Pse po e nisim punën
e se mbarojmë dot, përse ?
Pse ia gjejmë fillin
a mundi na shkon kot, përse ?
Pse ne veç po e mbjellim pemën
e tjetri e pret të bëjë fruta, përse ?
Pse, kur duhet t'i vjelim ne,
na i merr tjetri me nge, përse ?
Pse tjetri trimërohet historikisht
e neve na rëmben tuta mjerisht, përse ?
A ka kush të ma shpjegojë këtë sindrom

pse po ndodh me ne si rëndom, përse ?
A thua vallë akoma kështu do të shkojë?!
Këtë punë të mbrapshtë, dreqi le ta mallkojë !
SEPSE …! Nuk i duket fundi…, dhe
akoma s'dihet se si mbaron …?! PËRSE ?
Madje edhe shpresa….., po më lodh në pritje:
Përçarja, tradhëtia që më dalin në rritje
E po pyes unë, po pyes ngaherë
A ka kush të më përgjigjet
Por ama fjala në fyt mos t'i lidhet
Dhe as zëri mos t'i dridhet …!
Më, kur do të vijë për ne pranverë?
E dimri përfundimisht të zdirgjet !
SEPSE na ngriu palca sikurse n'acar…!
A gjaku po na shitet lirë, madje shum'lirë…!?
Tamam sikur t'ishte ujë që shitet n'pazar...?!
Ah, këta shitës e blerës ç'janë të marrë !
Bjelnë me okë e shesin me kandar….
Në pyetni për mua, nuk di se ku mbetem
Tek ujemi im, apo i llogaritur në darë ?
E unë, un' veç po vuaj se tretem,
sepse druaj për timen, at' t'moçmen Farë….!

FTESË PËR DARKË

I ftoj të gjithë në darken e shtruar
në sofër të madhe, mbushur përplot
me zemër të dlirë, mendje të kthjellët
fytyrë t'qeshur, fjalët kulluar
pa zënka, pa shantazhe, pa lot
drejt së vërtetës, vertikal sot e mot

*

Ftoj mikun; atë që më do
por, edhe atë që s'më do
edhe armikun; atë që më uren
por edhe at' që s'më uren
i grishi pa doreza, pa anamneza
si të thuash, në një të hapur teren
për dialog të çiltër e të mbarë,
me përkrahës dhe kundërshtues
madje edhe ata që më rinë kumbarë
pozitë, opozitë si dhe neutralë

*

Të gjithëve ua jap shancin[7]
njëlloj dhe pa ryshfete, veçse
drejt le ta shohin të vërtetën!
si të duan atë le ta ndjejnë!
por, kurrë për jetë të jetëve
veten e tyre, ashtu lehtas
e qetas, mos ta gënjejnë?!

*

Kur të flasin, përgjegjshëm,
drejt në sy le të shikojnë

[7] rastin

ndërgjegjshëm të kritikojnë
nëse duhet edhe të godasin
por ama, mirë le ta masin
se mos po e humbasin
atë që su kthehet përsëri
sikur edhe një herë të kthehen n'rini?!
E vërteta, thuan, është e hidhur
por ama, duhet gëlltitur gjithsesi.
Ne, pa hamendje, pimë pelinin e uruar
për ta shtypur në miden[8] tonë
vrerin rebel, të përditshëm
esull, aq shumë të trazuar?!

Tiranë, 6 shkurt, 2009

[8] lukth

GUR LAShTËSIE

Zgjohem e çohem dhe prapë kur bie
edhe kur më zen gjumi mes ëndrrash
aty un' jam sërish, mbi gur lashtësie
aty më zgjon nami mes zhgjëndrrash

***

Guri im, ti gur i moçëm breznishë
ti m'je gur lashtësie prej perëndishë
më rri gjithmonë me gatishmëri lirie
para e mbrapa më ndjek si hije
dhe ty, të gjejë përherë me mua
aty te koka e te këmbët më rri
vigjilent për çdo sekondë gjallimi
të kohës së shkuar në kalim, sepse
ti, nga fillimi e deri tek mbarimi,
një here fortë e thellë ngulesh
pastaj, kurrë më nuk shkulesh ?!

***

Un', nuk lindem për të jetuar,
sepse ndryshe si do bëhesh gur
por jetoj për tu rilindur dhe pastaj
për t'mos vdekur më kurrë!

***

Un' jam vetëmse një gur që digjet
për dritën e vet, që bëhet nur[9],
pasi ta ketë shkrepur xixën e shpirtit
nga vetja e vet, të paktën një herë,
dje, sot , nesër apo dhe dikur!

***

9

Un’jam guri i skalitur mjeshtërisht
pastaj i hedhur qiellit e tokës pas shpinës
dhe mbij sa herë që më kërkohet sublime
rrafsha ugarit apo lëndinës , sepse
kuptohet, jam nga ashti i nënës sime

***

Ndodh Pira me Dheu-kalion. Lashtësi!
apo ndonjë histori tjetër, e cila
qetësisht m’i kalon Dheut tim,
Dheut që më lind mua edhe ty

***

E përkujtoj atë, sepse ai vetë mua m’kujton
dhe asnjëherë nuk rastis të më haron,
për të dhe për vete, sa herë i bërë flijime?
prapëseprapë tim dheu i kthehem sublime!

IKJA NGA VETVETJA
(K o n v e r t i m i)

Kalojnë vitet e motet shkojnë
Hendeku sa vjen e thellohet
Rriten ndasitë me brezat
Në një trung dy degë shartojnë

Të një rrënje që të dyja janë
Madje i njëjti trung i mban
Më lartë degët të dallueshme janë
Dhe fruta të ndryshme kan'

Nuk i iket jo këj realiteti
Historia vetë le ta shkruaj'
Sepse ishim të një amaneti
E tani sillemi si dy të huaj.

10/gusht/2003
Reka e Epërme-Gostivar

KULIAT E ShEKULIIT

Kulla dridhet e nuk shembet
Blindat, topat n'qafë ç'i rranë, dhe
Ademit t'Jasharajve syri s'i trembet
Nga shkjau i stepës, nga serbianë
Kullën e mbron me sakrificën e vet
Me at sublimen, deri në vetëflijim
Edhe familja i bashkëngjitet në flijime
Për jetë a vdekje, të fisit festime
Kullës së Jasharajve nami i përsëritet
Gjaku i derdhur te pragu i Kullës
Për lirinë e Kosovës martire
Lulkuqe lirie do të rritet

***

Heroizmi mbjellet nga t'parët
Ai, shpejt mugullon n'tokë t'vet
Dhe gjithnjë e ushqejnë traditën
Si dikur edhe sot lapidarët
Kosova, më e kuqe se vet emri i saj
Ajo veç trima flamuri rritën

***

Kur i erdhi hasmi ballë për ballë
Dhe kur rretë e zezë n'derë i ranë
E pyeti trimin e lumja Zanë
O Ty lum Baci? Ti or kapedan!
Ti, që se njeh frikën në këto anë
Që ma ke dekën sikurse lindjen. Me nam!
Pa më thuaj, pash besën, një fjalë !
Ç'ke më të shtrenjtë në jetë me ma than'?
Kam lirinë e atdheut, që e kam vatan!

Tha trimi! –për të, edhe jetën time e jap falë!
Madje pak e kam, e po ta kisha edhe një tjetër
Përsëri për lirinë e Atdheut tim e kisha dhan’
Amanetin e t’parëve, pa e çue n’vend se kisha lan’!

NË DJEP TË KUJTIMEVE

Një Djep e kam dhe në at' qaj
Djepin e kujtimeve nga vetja se ndaj
Lidhur për shpirti fortë e mbaj
Në të përkundem deri sa s'shkundem
Qofsha në gëzim apo në vaj

*

Veçse ai lot i nxehtë shkul
Derdhur faqeve t'Botës përplot
Rrëfen dhimbjen që mu ka ngul
Për tokën time lënur nga mot
Ku varret e t'parëve n'perëndim
Pa ndal m'thirrin për një takim
E un s'po mundem me u dalun zot
Nga sfida emri që m'dalin sot, as
S'mund me e prekun truallin tim
N'shenjë kujtimi me u lexu këndim

*

Nga nostalgjia që kam në mërgim
Un', veç po e ndrydh këtʼ trunin tim
Plakem së largu, n'kujtim i thinjur
Me fijen e shpresës lidhun për shpirti
Mos me u shkëput nga gjeni im
Për ditë ma t'mira me u pa n'gëzim

*

Fort po m'buçet zemra ime sot
N'gjak t'Arbnit që i shkon n'vlim
Seç ma ushqen trunin tim o zot?!
Me t'bëmat e lashta t'popullit tim
Që m'i lanë t'parët n'trashëgim
Amanet për zgjimin tonë

Ngado ku frymojmë neve sot,
Sot o kurrë sa s'asht ba vonë!

*

Çamëri, ti Tokë Thesprote!
Shekuj varg në lot e n'gjak
Mbete n'gra e n'ndoj plak
Dhe n'do t'mi në konvertim
Rreth e përqark të sojit tim
Ngrën' e sosur veten n'dëshpërim
Nga shfarosjet me gjithë dëbim
Ndonse fëmija tu përgjak
Për Liri kur dhe kushtrim
U tundën: i ri edhe plak
Por, bota qe shurdhmemece
As nuk pa, e as u zu n'lak
Padrejtësia që Ty tu bë
Evropën plakë s'e bëri merak

*

Siç po i ngjet por edhe sot
Bash si ty dhe motrës jote
Nuset i marrin pa dullak[10]
Dardani i thënçin për mote
Mollën e kuqe e mban n'bajrak
Me një gluhë e me një resë
Përcjellë nga brezi n'brez
Bashkë llafosin me besa-besë
I njëjti gjak damarët ua ndez

*

Veçse loti i nxehtë shkul
Po m'sjellë n'mend atje ku jam

[10] duvak

Australi, Amerikë apo gjëkund
Kudo qofsha, me tu përkul
Nga ëndrra t'trishta me u shkund
Djepin e kujtimeve me e tund
Se s'po muj me dorë me t'prek
As nuk m'lënë në ty me hi
Ajrin tënd me e fut n'mushkëni
Ujin tënd n'burim me e pi, këtʼ
Dhimbjen time për me e shkul
Se mos vdeksha pa t'pa me sy
Por tu gëzofsha n'Tate Liri
Çamëri moj Çamëri
Se ku vete, se ku gdhi
Emri jot plot nostalgji
Mi mba hapur vesh e sy...!
Po, jam gjallë veç për ty...!
Herdo kurdo unʼ do t'vi
Të t'marrë nuse në shtëpi
Moj e imja Çamëri!
Do t'festojmʼ bashkë n'Liri....!

16, maj, 2007
Janinë, ÇAMËRI

KOHA QË PO JETOJMË

Thuan se, edhe dita
njihet që një mëngjes.
Këtë e di!-ma thonte bile
edhe gjyshi im, ndjesë pastë,
sa here që unë i jepja shkas
Thonte:-biro, i di Meta
punët e veta!
Më drejtë të themi se,
ne bimbarekët[11]
mirë i kemi punët,
tamam njashtu, siç i ka,
pas një meçi të rëndë,
boksieri hundët ?!
Kritika, patjetër, duhet
të jetë e shëndoshë
Realiteti është i hidhur
por megjithatë
duhet gëlltitur.

Po e pyes vetveten,
por edhe të tjerët:
A do të vijë koha
vallë ndonjëherë?
Që, këtë acar të egër
që na e mba shpirtin
në shtrëngim
Të'na e bëjë behar,
dhe atë t' bardhin dimër

[11] të bekuarit

t’ma kthejë n’pranverë
të mbushur n’blerim.

Edhe akullin spic, atë
akullin e shekujve, n‘vazhdim
t’na e shkrij’, ajo e zemrës valë.

Shiko, troç po ta them!
Ata që më vodhën dje,
po më vjedhin edhe sot?
Sa çudi! Askush s’po reagon?!
druhem e druhem, gjithnjë
e më tepër, se ç‘do të ndodhë
me mua nesër, pasnesër …?
Apo kush dreqi e di
se, çka do të bëhet
me gjeneratat që vijn’
mbase, njësoj si unë, edhe ata,
do të jenë fatkëqinj ?!

SALVIME ShPIRTI

Rrugës së larë nga gjaku e loti
të thekur e t'rrëpirë n'vazhdim
e përshkoj unë asketçe
madje përpiqem qysh moti,
Trupin dhe Unin n'salvim
për këtë punë të moçme
dhe për këtë hall të ri, se
jeta ndër breza kahmoti
më shkon ujvarë në blatim,
përpjekja saldon vuajtjet
deri në ditët e sotshme,
dhe fillet nga lashtësia
a sot në vendnumërim ?!

***

Për këtʼ mʼdëshmojnë rrudhat
e ballit tim të çarë, edhe
gjurmët e lotit të kryposur
fytyrës sime, coh të rreshkur,
frymëmmarjen zënë e marrë
si stalktit-stalakmitet që mʼrrinë
mollëzave vragë shekujsh murosur.

Ah, shpirti plekset veç me lirinë!
por i reckosur, i sakatosur e varrosur
dhe ringritet, përngjitet, shërohet e
rritet si filiz përsëri, vetëm atëherë
kur njeriu ….., e dëshmon për njerinë!

***

Ndonse i njomë herët e i thinjur vonë
gjeni kërkohet…dhe natën pa fener,

Shqipja nxjerr dy koka, veshur me kurorë
njëra shikon lindjen e thirr me ezanë,
tjetra perendimit i thirr me kambanë
i vdekur e i lindur sërish do t'm'i thonë:
Det i kreshpëruar, n'kreshta malesh flakur
në djersë të trupit t'vet i qullur
n'gjakmarrje dejsh i plakur!?
zemrat n'pulsim e këndojnë epopenë
salvon Shpirti për Mëmëdhenë..!

***

Shkithen rreth mua edhe të tjerë
madje me mall e dëshirë përherë
t'zhytur në gjak therjesh, lemeri
korba kobzezë, e zemërmjerë
shpirtprishur e vesbishë-njeri
ata s'dinë të qajnë njerëzisht
prandaj s'kanë vragë lotësh të tharë
as balli i tyre rrudha nuk u mbanë ?!
shenjat e viteve për ta nuk janë, se
ata su plakën ndër zotëra ndonjëherë,
dhe kurrë s'mund të jenë për ta krenarë
nuk e provuan mbijetesën asnjëherë...
s'janë dhe as që mund të bëhen
ndonjëherë si un' lottharë.

ShPJEGIM S'GjEJ DOT

Si gjatë hamendem un' kot
Shpjegimin nuk e gjej dot
Për shumë pyetje,sot e mot
Që lidhen me çështjen tonë
Që sot mua kot më mundojnë
Por i kanë munduar dhe të tjerët
Para meje, madje shumë më herët
Ndoshta do t`i mundojnë akoma
Edhe shumë të tjerë më vonë
Gjithmonë të brengosur
Për të ardhmen tonë
Që është bërë lëmsh
Dhe rri sikurse litari
I futur tërkuzë në thes
Përcjellur e pritur
Nga brezi në brez.

***

Shpjegimin e kërkoj
Nëpër kohë ndjekur
Sqarim pata kërkuar
Nga njerëz ndër shekuj
Në përpjekjet e tyre
Të përflakura e përgjakura
Paguar dhe me jetë
Luftuar heroikisht
Se rranë dëshmorë vetë
Shpjegimin e kërkova
Madje duke bredhur
Nëpër Trojet e mia, dhe
Duke ecur zbathur

Nëpër fshatra e kërkova
Por dhe qytete të reja
E të vjetra i përshkova
Shpjegimin prapë se gjeta
Kërkimin më tej e vazhdova
Me aq forcë sa më jepte jeta
E sa më lejonin rrethanat
Si të huajat ashtu dhe tonat
***
Por su ndala, as nuk pushova
Sepse zgjidhjen e kërkova
Edhe tek ekonomia
Por edhe tek politika, tek
Sinqeriteti dhe dinakëria
Tek forca e tek strategjia
Edhe e të mive shokë e miq
Edhe e të huajve miq e armiq
Shpjegimin e kërkova prore
Edhe tek dija dhe shkollimi
Te punësimi dhe emancipimi
Por nuk e gjeta asgjëkundi
As tek fillimi, as tek fundi
***
Si në kohë të vështira
E si në kohë të Artë
Nga gjithë kjo që ceka
Këtu pak më lartë. E
Merre me mend mundimin
I
shkreti, seç hiqte
Nga torturat e shantazhet
Nga më të ndryshmet

Sepse donte ta nxirrte
Mbase të drejtë shpjegimin
Nga vetë shpirti i çiltër
Në flijim më sublimin.
Për jetëzgjatje filtër
Nga zemra e zjarrtë
E fisit tim fjokart
Ngarkuar me punë,
E realizuar në vepra
Gjithmonë në vazhdim
Drejtuar, ecur e shkuar
Përherë dhe gjithnjë
Nga Lindja në Perëndim.
N'përqafim pas Diellit tim.

Tetovë-zyra ime, ora 13,05
e shtunë, 31 janar, 2004

P Ë R M B A J T J A

1.DRITA E YLlIT 5
2.ATJE TE DODONA..... 6
3.JAM AI QË IShA..... 7
4.MALlI PËR ATDhEUN(Mërgimtar it) 8
5.SI ERDhI ZAMANI..... 10
6.ATY TEK PORTA SKEE 12
7 NËN DEGËT E LISIT PLAK..... 15
8.PRITJE ShEKULlORE..... 17
9.YJE TË NDEZUR FLAKË..... 19
10.RAPSODI KËNDOI EPOPENË..... 20
11.VETËMOHUESI(Ademit-maratonistit tetovar) 22
12.LIQENI i STRUGËS..... 24
13.DETI NË TETOR..... 25
14.DIALOG NDJENjASh E ËNDRrASh..... 26
15.SYTË E TU TË BUKUR(vajzës Iliridase) 29
16.LOKEJONA..... 31
17.KUR FLET ShPIRTI I POETIT..... 33
18.A N K I M I..... 36
19.A VONOHET PRANVERA..... 38
20.Dhjetë minuta në vigjilje të vitit të Ri 40
21.I L I R I D A 42
22.SI TA VRAS MËRZINË 45
23.EMISARËT GRI(fytyrat e hirta) 48
24.E … PO PYES…. 51
25.FTESË PËR DARKË..... 53
26.GUR LAShTËSIE..... 55
27.IKJA NGA VETVETJA(Konvertimi)..... 57
28.KULlAT E ShEKULlIT..... 58
29.NË DJEP TË KUJTIMEVE 60
30.KOHA QË PO JETOJMË..... 63

31.SALVIME ShPIRTI..... 65
32.ShPJEGIM S'GJEJ DOT..... 67
RrETh POEZIVE 70
PËRMBAJTJA..... 80
C I P..... 82

KASAM ISMEN ShAQIRVELA

KËNGË TË VONUARA

Përgatitur për shtyp nga
Shtëpia Botuese **V E L A**

Botoi: JETA-AIR
T e t o v ë

Drejtor i botimit
Kasam I. ShAQIRVELA

Realizimi kompjuterik: *Blerim Shaqiri*

Kopertinat: *Arta Shaqiri*

Tirazhi 1000 kopje
U shtyp në Shtypshkronjën "TringaDesign" – Tetovë, 2010

Botimi i librit u sponsorua nga JETA-AIR

CIP - Katalogimi në publikim
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare
"Shn. Kliment Ohridski", Shkup

821.18(497.7)-1

ShAQIRVELA, Kasam
Këngë të vonuara : letërsi artistike / Kasam Shaqirvela. - Tetovë : Vela, 2008. - 80 f. ; 21cm. - (Biblioteka Muza : poezi e poema)

ISBN 978-9989-2668-9-8

COBISS.MK-ID 73344010